



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 807/2 prot.,

Datë 18.04.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60102-02-23-2023 me objekt: “*F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore të rikonstruara*” – *Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj*”, me fond limit 31,848,016.63 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor, *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “KLAME” SHPK.  
Adresa: Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr. 23, Kati i dytë, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Adresa: Rruga e Kavajës Nr.1001, Tirana, Albania.

Në datën 14.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 807 prot., e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60102-02-23-2023 me objekt: “*F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore të rikonstruara*” – *Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj*”, me fond limit 31,848,016.63 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor, *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KLAME” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 807 prot., datë 14.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik rezulton se:*

➤ *Tek Sigurimi i Ofertës, periudha e vlefshmërisë së ofertës nuk është në përputhje me periudhën e përcaktuar tek Njoftimi i Kontratës në DST 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, pasi OE e ka paraqitur 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.*

➤ *Edhe pse Operatori Ekonomik ka plotësuar pikën 5 tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit duke specifikuar origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, nuk ka vetëdeklaruar origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese në shtojcën 2 të DST, siç kërkohet në pikën 3 të Krieteve të Vecanta të Kualifikimit.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 18.04.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**